



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 22

Prishtinë, më 16 shkurt 2016, në orën 10:30

Ndërtesa e Kuvendit, sala C-203

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Enver Hoxhaj, Teuta Rugova, Elmi Reçica e Ismet Beqiri.

Munguan: Qerim Bajrami, Blerta Deliu Kodra, Glauk Konjufca e Zafir Berisha.

Në takim ishte i pranishëm z. Jason Steinbaum, këshilltar i anëtarit të Kongresit z. Eliot Engel, me bashkëpunëtorë.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi.

Pjesëmarrës të tjerë: Genc Jaha- KDI dhe media.

Mbledhjen e kryesoi: Enver Hoxhaj, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 13 tetor 2015 dhe 21 janar 2016;
3. Raporti vjetor i punës së Komisionit për vitin 2015;
4. Shqyrtimi i planit dhe programit të punës së Komisionit për vitin 2016;
5. Të ndryshme;
6. Takim me z. Jason Steinbaum, këshilltar i anëtarit të Kongresit z. Eliot Engel.

Enver Hoxhaj, kryetar, konstatoi se në mbledhje nuk pati numër të mjaftueshëm të deputetëve, për t'i shqyrtuar dhe miratuar pikat e propozuara në rendin e ditës.

Anëtarët e Komisionit të pranishëm në këtë mbledhje debatuan për çështjet e propozuara në rendin ditës, për Raportin vjetor të punës së Komisionit për vitin 2015, Planin dhe Programin e punës së Komisionit për vitin 2016 dhe çështje të tjera nga fushëveprimtaria e Komisionit.

Nga ora 11:00, Komisioni kishte paraparë takimin me z. Jason Steinbaum, me ç'rast në këtë takim ishin të pranishëm deputetët Enver Hoxhaj, Teuta Rugova, Elmi Reçica, Ismet Beqiri dhe Zafir Berisha.

1. Takim me z. Jason Steinbaum, këshilltar i anëtarit të Kongresit z. Eliot Engel.

Enver Hoxhaj, fillimisht i dëshiroi mirëseardhje z. Jason Steinbaum, këshilltar i kongresistit z. Eliot Engel dhe prezantoi anëtarët e Komisionit. Z. Hoxhaj tha se z. Jason Steinbaum është mik dhe mbështetës i madh i Kosovës për më se dy dekada dhe bashkëpunëtor i kongresistit Engel. Në emër të Komisionit falënderoi z. Engel për rolin që ka pasur që vendet e caktuara ta njohin Kosovën, nga se ka qenë një kontribut i koordinuar, i përbashkët që vendet e caktuara të marrin një vendim për Kosovën. Ai u shpreh mirënjohës SHBA-ve, për kontributin e dhënë për anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare, për hapjen e negociatave për MSA-në dhe për mbështetjen që ka marrë Kosova për sfidat e Mileniumit, duke theksuar se z. Engel dhe z. Steinbaum mbeten adresa e jonë më fuqishme në Amerikë. Po ashtu, Hoxhaj bëri të ditur interesimin për formimin e Grupit të Miqësisë me Kongresin Amerikan.

Jason Steinbaum theksoi se ka pasur kënaqësi dhe nder që të punojë për Kosovën, dhe puna për Kosovën ka qenë pjesa më e mirë e punës së tij për më se 20 vite. Kosovën e sheh duke përparuar dhe në zhvillim e sipër.

Ndihmën të cilën i ka ofruar popullit të Kosovës, Steinbaum tha se ka qenë shumë e vlefshme për të dhe se populli i Kosovës është mirënjohës për këtë ndihmë. Mirënjohja e popullit të Kosovës ndaj SHBA-së për mbështetjen që u kemi dhënë, tha se e bënë punën tonë më të lehtë dhe më të kënaqshme.

Zafir Berisha tha se është kënaqësi që të takohemi me një njeri që ka bërë shumë për Kosovën dhe se jemi mirënjohës për mbështetjen e SHBA-së, në proceset tona. Pa ndihmën e miqve tanë nuk do të mund të arrinim këtu dhe se është bërë një punë e madhe për Kosovën. Berisha tha se ka sfida, bisedimet në Bruksel kanë krijuar përplasje në mes të pozitës dhe opozitës dhe se Serbia shpesh na nxjerr para aktit të kryer dhe krijon rrethana jo të mira në Kosovë. Kosova ka ambicie që të jetë një shtet, pjesë e familjes evropiane dhe shembull për rajonin. Ne mburremi me mbështetjen dhe miqësinë që kemi me SHBA-të, që është aleati kryesor i projektit të Republikës së Kosovës.

Teuta Rugova në diskutimin e saj falënderoi z. Steinbaum, për ndihmën që i është dhënë Kosovës nga SHBA-të. Ajo theksoi se Kosova ka nevojë ende për ndihmën dhe miqësinë me SHBA-të, në proceset e mëtejme.

Ismet Beqiri këtë takim e konsideroi të veçantë. Për SHBA-të dhe popullin amerikan, tha se është vështirë të gjenden fjalë miradije dhe respekti, për të respektuar një shtet që ka bërë shumë për ne. Falë angazhimeve tona shumëvjeçare, luftës institucionale që e kemi bërë për atë që kemi pasur mundësi nën udhëheqjen e Presidentit Rugova, luftës së UÇK-së, veçmas ndihmës vendimtare të SHBA-ve dhe aleatëve, ne sot jemi këtu, përndryshe jemi të bindur se asnjëherë nuk do të ishim shtet përkundër të drejtës tonë, po të mos ishte përkrahja e SHBA-ve.

Elmi Reçica duke u ndërlidhur me raportet mes Kosovës dhe SHBA-së, tha se i jemi shumë mirënjohës SHBA-së ngase së pari e kanë mbajtur gjallë qenien tonë, sepse kemi qenë para një shpërbërjeje, para një zhdukjeje. Më pas kemi pasur përkrahjen për lirinë, pavarësinë, integritet, zhvillimet dhe mbështetjen për anëtarësim në mekanizmat ndërkombëtarë. Synimet e shtetit tonë, të popullit tonë, janë ato të deklaruara, miqësia e përhershme me SHBA-të dhe integritet . Përkundër vështirësive të cilat i kemi, ne jemi të përkushtuar që t'ia dalim duke u bërë pjesë e atyre mekanizmave që janë në interes të qytetarëve e të shtetit, theksoi Reçica.

Jason Steinbaum , mes tjerash tha se miqësia e z. Engel dhe e tija, me Kosovën është e përhershme, por kjo miqësi është mirë që të shtrihet edhe me kongresistë të tjerë. Kosova duhet të punojë të jetë kreative, ka shumë për të bërë rreth njohjeve dhe anëtarësimit në organizata ndërkombëtare.

Enver Hoxhaj duke ju falënderuar z. Jason Steinbaum për vizitën, shprehu shqetësimin e Komisionit për Punë të Jashtme, i cili tha se është afatgjatë e që ka të bëjë me faktin se edhe në vitin e tetë të pavarësisë së Kosovës, Kosova vend i pavarur, sovran ka integritet të qartë territorial, por nuk është anëtarë i OKB-së. Lidhur me këtë shqetësim afatgjatë, tha se beson se në një të ardhme të afërt do të krijohet një dritare e mundësisë në bashkëpunim me Kongresin dhe partnerët e tjerë për të arritur që të anëtarësohemi edhe në OKB.

Hoxhaj theksoi po ashtu, se falë mbështetjes së SHBA-së kemi hapur negociatat për MSA-në, por shprehu shqetësimin se nëse edhe më tutje pesë vendet anëtare të BE-së nuk e njohin Kosovën do të kemi vështirësi të aplikojmë për statusin e kandidatit për anëtarësim në BE dhe duke diskutuar për nevojën e liberalizimit të vizave për Kosovën, kërkoi mbështetjen e SHBA-së edhe në këtë drejtim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:05.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit

Enver Hoxhaj